

SHOQËRIA "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A
ADRESA: RR. "MUHAMET GJOLLESHA", TIRANË
NUIS J61807025P

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQËRISË "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A.

Sot, më datë 21.06.2021, në orën 10:00 në Tiranë, Shqipëri, pranë selisë së Shoqërisë "BOTIMET ENCIKLOPEDIKE" SH.A., në adresën: "Muhamet Gjollësja", Tiranë (këtej e tutje "Shoqëria"), u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Janë të pranishëm

- **Znj. Ajola Arben Xoxa**, dtl. 16/07/1983, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal I35716050T, që zotëron që zotëron 2410 aksione të Shoqërisë, apo 40,167% të kapitalit aksionar, dhe që njëkohësisht ushtron detyrën e Administratores së Shoqërisë;

- **Znj. Valbona Xhemil Xoxa**, dtl. 09/10/1958, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me kartë identiteti me nr. personal F86008097P, që zotëron 2314 aksione të Shoqërisë, apo 38,567 % të kapitalit aksionar, dhe që vepron në cilësinë e Kryetares së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- E pranishme është edhe **Znj. Xhoi Skënderasi**, dtl. 08.09.1992, lindur dhe banuese në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal J25908048T që caktohet për të vepruar në cilësinë e Sekretarit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Kryetarja e Asamblesë, Znj. V. Xoxa, deklaron se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është thirrur dhe mbledhur rregullisht, konform ligjit dhe Statutit të Shoqërisë, pa patur ndonjë kundërshtim nga secili prej aksionerëve në lidhje me këtë, për të diskutuar e vendosur mbi Rendin e Ditës së mëposhtëm.

Rendi i Ditës

- I. Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë;
- II. Miratimi i Bilancit të Vitit 2020;
- III. Të ndryshme.

Pasi konstaton praninë e të gjithë aksionerëve të sipërpërmendur.

Deklaron

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë si të mbledhur rregullisht dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës.

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Kryetarja e mbledhjes merr fjalën dhe sqaron se Shoqëria disponon disa prona të paluajshme të cilat nuk janë rivlerësuar asnjëherë dhe si pasojë, janë ende të regjistruara me një çmim tepër të ulët.

Kryetarja sqaron se, në kushte normale, rivlerësimi i pasurisë së shoqërive bëhet me një vlerë tatimi të barabartë me 15%, ndërkohë që aktualisht, një ligj i posaçëm në fuqi (Ligji Nr. 90/2019 "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", i ndryshuar) e lejon Shoqërinë të kryejë rivlerësimin e pronave të saj duke paguar vetëm 5%.

Përveç kësaj, Kryetarja rikujton se nuk ka kryer asnjë rritje kapitali që prej themelimit të saj në vitin 1996.

Si pasojë, me qëllim kryesisht rivlerësimin e pronave të paluajtshme të Shoqërisë, proces i cili nevojit investimin e një shume të madhe parash, por jo vetëm, edhe me qëllim rregullimin e disa pjesëve të dëmtuara strukturore të godinës ku Shoqëria kryen aktivitetin e saj, Kryetarja propozon zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë përmes emetimit të 16'000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) mijë aksioneve të reja, me vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra në total vlera e të gjitha aksioneve që do të emetohen është e barabartë me 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetë milion Lekë).

Aktualisht, Shoqëria disponon 6'000 (gjashtë mijë) aksione, me një vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra me një vlerë totale të barabartë me 6'000'000 (gjashtë milion lekë).

Në lidhje me Rendin e Ditës, Kryetarja i hedh në diskutim dhe në vijim të deklarimeve të sipërlistuar, pas një diskutimi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

VENDOS

- Zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nëpërmjet emetimit të 16'000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) mijë aksioneve të reja, me vlerë nominale 1'000 (një mijë) Lekë secili, pra në total vlera e të gjitha aksioneve që do të emetohen është e barabartë me 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetë milion Lekë). Çdo aksionar i Shoqërisë ka të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, dhe specifikisht ka të drejtë të nënshkruajë një numër aksionesh të emetuara në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tij. Kjo e drejtë duhet të ushtrohet përmes njoftimit të Administratorit të Shoqërisë jo më vonë se 20 ditë pas publikimit të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

- Autorizimin e Administratores së Shoqërisë, dhe në mungesë të saj çdo person tjetër të autorizuar prej saj, për kryerjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të kërkuara nga legjislacioni shqiptar për realizimin e operacionit të zmadhimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.


II. MIRATIMI I BILANCIT TË VITIT 2020

Kryetarja informon të pranishmit se Administratorja e Shoqërisë ka dorëzuar Bilancin/Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2020, hartuar nga ekspert kontabël, Z. Artan Golemi dhe ia paraqet ato Asamblesë.

Të pranishmit nuk kanë asnjë kundërshti në lidhje me Pasqyrat Financiare të Dorëzuara dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

VENDOS

- Miratimin e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2020 dhe mandaton Administratoren ose një person tjetër të autorizuar prej saj që të kryejë depozitimin e Pasqyrave Financiare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve apo institucioneve të tjera, sikurse mund të kërkohej nga ligji.



III. TË NDRYSHME

Kryetarja pyet të pranishmit nëse kanë ndonjë temë tjetër për të diskutuar.


Duke qenë se të pranishmit nuk kanë tema të tjera për të diskutuar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, unanimisht:

VENDOS

- Mandatimin e Administratores së Shoqërisë, Znj. Ajola Xoxa, ose një personi tjetër të autorizuar prej saj me shkrim, që të kryejë regjistrimin e këtij vendimi të Asamblesë së Përgjithshme pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, sikurse edhe çdo institucioni tjetër ku mund të jetë e nevojshme; gjithashtu edhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme apo të dobishme me qëllim zbatimin e të gjitha vendimeve të marra në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.


Duke qenë se nuk ka çështje të tjera për të diskutuar dhe duke qenë se askush tjetër nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:30.

Znj. Valbona Xoxa


Kryetare e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë



Znj. Ajola Xoxa


Aktionare/Administratore

Znj. Xhoi Skënderasi


Sekretar i Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë

Tiranë, më 02/11/2021

**DEKLARATË/NJOFTIM PËR REALIZIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” SH.A.**

Unë e nënshkruara, Ajola Xoxa, duke vepruar në cilësinë e Administratores së shoqërisë “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” sh.a. (këtu e në vijim “Shoqëria”), me zyrë qendrore në adresën: Rruga “Muhamet Gjollësja”, Tiranë, shoqëri e pajisur me NUIS J61807025P

DEKLAROJ SE:

Më datë, 21.06.2021, në orën 10:00, në selinë e Shoqërisë, u mbledh rregullisht Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, e cila vendosi, ndër të tjera, edhe zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë (bashkëlidhur kësaj deklaratë), nëpërmjet emetimit të 16'000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) aksioneve të reja, me vlerë nominale 1000 (një mijë) Lekë secili, me vlerë totale të barabartë me 16'000'000 (gjashtëmbëdhjetë milion) Lekë, ku u parashikua se çdo aksionar i Shoqërisë ka të drejtën e parablerjes për aksionet e emetuara rishtazi, në përpjestim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tij, e drejtë kjo e cila duhej të ushtrohej prej tyre jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pas publikimit të vendimit për zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 169, pika 3, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas realizimit të zmadhimit të kapitalit, administratorët i njoftojnë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit realizimin e këtij veprimi. Informacioni shoqëruar duhet të përfshijë listën e personave, që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara. Kjo listë nënshkruhet nga administratorët”, dhe autorizimit nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur rregullisht më datë 21.06.2021, ku u vendos, ndër të tjera, autorizimi i Administratores të Shoqërisë, znj. Ajola Xoxa të ndjekë të gjitha procedurat për operacionin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, me anë të kësaj deklaratë, deklaroj se aksionarët të cilët kanë ushtuar të drejtën e parablerjes të parashikuar në nenin 174 të ligjit të sipër përmendur janë si më poshtë vijon:

1. Valbona Xhemil Xoxa, e cila në përpjestim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej saj, ka nënshkruar 6171 (gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) aksione të reja, me vlerë nominale 1000 (një mijë) Lekë secili, me një vlerë të barabartë me 6'170'667 (gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë.

Për rrjedhojë, duke qenë se aksionerët e tjerë të Shoqërisë nuk e kanë ushtruar të drejtën e parablerjes brenda afatit të parashikuar në nenin 174 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, rezulton se kapitali i Shoqërisë është zmadhuar në vlerën totale prej 6’170’667 (gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë, vlerë e cila përkon me shumën e paguar nga aksioneri i lartpërmendur që ka ushtruar të drejtën e parablerjes.

Pra, me realizimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë, kapitali i regjistruar i Shoqërisë rritet me 6’170’667 (gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë dhe bëhet 12’170’667 (dymbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë.

Si përfundim, deklaroj:

1. Realizimin e veprimit të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” sh.a.

Bashkëlidhur kësaj deklarate gjenden:

- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “BOTIMET ENCIKLOPEDIKE” sh.a., datë 21.06.2021;
- Lista e aksionerëve që kanë nëshkruar aksionet, së bashku me shumën e paguara prej tyre;
- Vërtetimi i drejtorisë rajonale tatimore mbi të dhënat e deklaruara nga aksionari kontribues në shtimin e kapitalit në formën monetare nga jashtë shoqërisë;
- Lista e të gjithë aksionarëve të Shoqërisë së bashku me numrin e aksioneve të zotëruara prej tyre, si dhe pjesëmarrja e tyre në Shoqëri e shprehur në përqindje, si pasojë e realizimit të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë.

Për BOTIMET ENCIKLOPEDIKE SH.A.

Znj. Ajola XOXA

Ajola Xoxa
Botimet Enciklopedike Sh.a.
Nipi: J61807025P
Tiranë

Botimet Enciklopedike sh.a
J61807025P
Muhamet Gjollësia,
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 02.11.2021

Lista e Aksionarit që ka nënshkruar aksionet dhe shumat e paguara prej tij

Nr	ID	Emri	Atësia	Mbiemri	Aksione	Vlera nominale	Shuma e paguar
1	F86008097P	Valbona	Xhemil	Xoxa	6,171	6,170,667	6,170,667

Për "Botimet Enciklopedike" sh.a

Administrator

Znj. Ajola Xoxa

Botimet Enciklopedike
Nip. J
Tiranë



Ajola Xoxa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE TIRANË
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TATIMPAGUESVE

Nr. 19374 Prot

Tiranë, më 19/8./2021

Lënda: Konfirmimi i DRT Tirane mbi te dhenat e deklaruar nga individit kontribues ne shtimin e kapitalit ne formen monetare nga jashte shoqerise.

Për Subjektin: BOTIMET ENCIKLOPEDIKE me nipt J61807025P ✓
Adresa: M.GJOLLESHA

Për dijeni: Qendra Kombëtare e Biznesit

TIRANË

TIRANE

Drejtoria Rajonale TatimoreTirane, bazuar ne deklarimin e ortakut te shoqerise : **BOTIMET ENCIKLOPEDIKE me nipt J61807025PZ**. Valbona Xoxa me nr. personal F86008097P mbi burimin e te ardhurave te cilat do te perdoren prej tij per shtimin e kapitalit, pasi analizoi shumat per cdo element, te dhena ne deklaratat e tyre (kopje bashkengjitur) dhe pas kontrollit te pagesave te tatimit mbi çdo element te dhene prej deklaruesve, konfirmon se:

Te ardhurat sipas zerave te deklaruar jane taksuar si me poshte vijon:

- 1.Per te ardhurat e siguruara nga marredheniet e punesimit te ushtruara ne Republiken e Shqiperise ne shumen 0 leke, eshte paguar tatim mbi page ne Shumen 0.leke;
- 2.Per teardhuratngaveprimtariakulturoreapo sportive/veprimtaritetjerapersonale ne Republiken e Shqiperise ne Shumen zero lekeeshtepaguartatimmbi page ne Shumen zero leke;
- 3.Perteardhurat e siguruarangaveprimtaria a zhvilluarsijorezident, nepermjetnjepersoni me seliteperhershme ne Republiken e Shqiperise ne Shumen zero lekeeshtepaguartatimmbi page ne Shumen zero leke;
- 4.Nga te ardhurat e siguruara nga kalimi i se drejtes se pronesise ne Shumen 6.170.667 leke për të cilën është paguar tatim në burim.
- 5.Nga te ardhurat e siguruara nga pronesia mbi pasurite e paluajtshme, ne Shumen zero leke,paguar tatimi i mbajtur ne burim ne vleren zero leke.
- 6.Nga te ardhurat e siguruara nga kalimi i pronesise mbi pasurite e paluajtshme, ne Shumen zero lekë.
- 7.Nga te ardhurat e siguruara nga dividendet e shperndare nga personi juridikne shumen totale 0 lekë , per te cilen paguar Tatimi mbi dividendin ne vleren 0 leke;
- 8.Nga te ardhurat e siguruara nga pjeset e fitimit ne Shumen zero leke te paguar nga ortakeria rezidente me vleren zero leke.
- 9.Nga te ardhurat e siguruara nga interesat ne shumen totale zero leke;
- 10.Nga te ardhurat e siguruara nga e drejta e autorit apo pronesia intelektuale,qeraja,emfiteoza ne shumen totale zero leke
- 11.Nga te ardhurat e siguruara ne lojrat e fatit ne shumen totale zero leke;
- 12.Nga te ardhurat e siguruara prej meje si person jorezident nga sherbimet e kryera ne territorin e Republikes se Shqiperise ne shumen totale zero lekë
- 13.Nga te ardhurat e tjera te siguruara qe nuk identifikohen sa me lart.



Header Data

MT: 103 (Single Customer Credit Transfer)
 LT: USALALTRXXX (INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SH.A. | XXX | TIRANA)
 Correspondent: NCBAALTRXXX (BANKA KOMBETARE TREGTARE SH.A. | XXX | TIRANA)
 Priority: N
 TRN: 000FOIL212360004
 Currency/Amount: ALL/6170667
 Value Date: 8/26/21
 MPS-ID: 19408186
 Status Description: Sent Message (ALB)
 Print Time: 11/4/21 10:46:27 AM
 Print User: U357776
 Last Acting User:
 Appl. Queue/Journal: BOX-FIN-Archive-ALB

Acknowledgment Data

Device Code: No error occurred.
 Protocol Code: SUCCESS

 - - - - Start Of ACK/NAK - - - -
 Service Message Type 21 - Acknowledgement of GPA and FIN Messages (ACK/NAK)
 Basic Header: LT Ident: USALALTRXXX Sess. no: 3012 Seq. no: 705846
 177 - Date and time: 2108241652
 451 - Acceptance: 0 (accepted)
 108 - MUR: 000ALBA21236015
 - - - - End Of Message - - - -

Original Message

 - - - - Start Of Message - - - -
 Message Type 103 - Single Customer Credit Transfer
 Basic Header: LT Ident: USALALTRXXX Sess. no: 3012 Seq. no: 705846
 Appl. Header: Receiver: NCBAALTRXXX Priority: N
 User Header : 103 - Service Code: AIP
 108 - Message User Reference: 000ALBA21236015
 121 - Unique EToE Trans. Ref.: 2bc782de-4473-4861-9983-0f29714f3bb0
 20 - Sender's Reference: 000FOIL212360004
 23B - Bank Operation Code: CRED
 32A - Val.Dt./Curr./Interb. Settled Amt.:
 Date : 210826
 Currency: ALL
 Amount : 6170667, (6.170.667,00)
 33B - Currency/Instructed Amount:
 Currency: EUR
 Amount : 50829,22 (50.829,22)
 36 - Exchange Rate: 121,4 (121,4)
 50K - Ordering Customer:
 Account : AL71208110080000048298635102
 Name and Address: VALBONA XHEMIL XOXIA
 033094353 RR VASO PASHA P 15 SHK
 22 AP 28 TIRANE AL
 53A - Sender's Correspondent:
 Identifier Code: STANALTRXXX (BANK OF ALBANIA | XXX | TIRANA)
 59 - Beneficiary Customer:
 Account : AL3520511014000162CLPBCLALLO
 Name and Address: BOTIMET ENCIKLOPEDIKE
 AL
 70 - Remittance Information:
 KALIM PER ZMADHIM KAPITALI
 71A - Details of Charges:
 OUR
 Msg. Trailer: CHK - Checksum: 5FE5265A5248
 - - - - End Of Message - - - -

Handwritten signature in blue ink over a blue ink stamp that reads "INTESA SANPAOLO BANK Albania Dega Tirane".